

[REDACTED]

**KËRKESË ANKIMORE**

**Drejtuar:** Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS)

në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

**Adresa:** Rruga " Ibrahim Rugova", Ndërtesa nr.4: Tiranë

KA-51

40.5.2021

21:45


<b>ANKUESI</b>	
<i>Subjekti Zgjedhor Kandidat i propozuar nga Zgjedhësit Boiken Abazi</i>	<i>Boiken Abazi Rr. Kongresi i Lushnjës, pall.37, shk.1, ap. 9 Tiranë, Shqipëri Tel: 0698693169</i>

<b>OBJEKTI I ANKIMIT</b>	
<b>1. Kërkesë për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në:</b>	
Zonën Zgjedhore Qarkun Tiranë	
<b>2. Kundërshtimi i Vendimit të KZAZ / KSHZ</b>	
Vendimi	Titulli i Vendimit: "Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse për rezultatin e votimit në zonën zgjedhore Qarku Tiranë, për subjektet zgjedhore dhe kandidatët për deputetë në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021".
Nr.	Datë
343	04/05/2021
Bazuar në nenin 21, 123/1, 124, 124/1 dhe 126, neni 160, pika 2 dhe 3, neni 161, pika 1 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar	

**PËRSHKRIMI I SHKELJES SË PRETENDUAR**

Boiken Abazi

1. Shkeljet që lidhen me pengimin e vëzhguesëve të kandidatit të pavarur Boiken Abazi, dhe të vetë kandidatit.
  - 1.1 Kryetarët e tetëmbëdhjetë (18) KZAZ-ve kanë penguar hyrjen brenda Vendeve të Numërimit të Votave (VNV) përkatëse, gjatë kohës së pranimit të kutive në VNV, duke mos i lejuar vëzhguesit të monitorojnë procesin e pranim-dorëzimit të kutive të votimit, në kundërshtim të Kodit Zgjedhor.
  - 1.2 Pasi kryetarët e KZAZ-vë kanë pranuar kutitë e votimit në VNV, kanë nisur të thërrasin dhe lejojnë hyrjen në VNV në mënyrë arbitrare, vetëm të atyre vëzhguesve që ata kanë përzgjedhur subjektivisht.
  - 1.3 Brenda VNV-ve as nuk ka pasur e as nuk është zbatuar asnjë rregull për ndarjen e barabartë të hapësirës së monitorimit për vëzhguesit e akredituar. Pozicionimi i vëzhguesve të kandidatit Boiken Abazi pranë ekraneve dhe tavolinave të numërimit, në shumicën e rasteve është pamundësuar për shkak se kryetarët e KZAZ-ve u jepnin përparësi subjekteve që përzgjidhnin në mënyrë arbitrare, duke spostuar fizikisht vëzhguesit tanë si dhe duke i kërcënuar me largim nga VNV-të.
  - 1.4 Policia e Shtetit ka zbatuar urdhra të paligjshëm të dhëna nga kryetarët e KZAV-ve duke penguar hyrjen në VNV të vëzhguesve të akredituar të kandidatit të pavarur Boiken Abazi, si dhe të vetë kandidatit, duke mos qenë e paanshme në kryerjen e detyrave për të garantuar trajtim të barabartë të të gjitha subjekteve politike.
  - 1.5 Prania në masë brenda VNV-e të personave të paautorizuar (të paakredituar), përkatësisht familjarë dhe mbështetës të shtabit të kandidatëve të subjekteve të tjera zgjedhore duke shkaktuar tensione, duke ndërhyrë me fjalë e deri të përdorimi i dhunës fizike.
2. Shkelje që lidhen me vota të pavlefshme, të cilat, në total, për Qarkun Tiranë kanë qenë 18.422 fletë votimi:
  - 2.1 Vendimi për ta shpallur një fletë votimi të pavlefshme ka patur standarde të dyfishta edhe në të njëjtën tavolinë numërimi e në të njëjtën VNV. Standardi ka ndryshuar edhe nga njëra VNV tek tjetra. Në të njëjtën tavolinë numërimi, vota për kandidatin e pavarur shpallej e pavlefshme nëse kishte një shënim diku në cep të fletës së votimit, por nuk shpallej e pavlefshme në rastin kur shenja të ngjashme në cep të fletës së votimit i përkiste një subjekti tjetër politik.
  - 2.2 Vëzhguesit e kandidatit të pavarur Boiken Abazi kanë konstatuar raste kur janë shpallur shumë fletë votimi të pavlefshme pa asnjë arsyetim, dhe kontestimet e atypëratyshme nga vëzhguesit e kandidatit të pavarur Boiken Abazi nuk janë marrë parasysh nga grupi i numërimit dhe kryetari i KZAZ-së përkatëse.
  - 2.3 Vëzhguesit e kandidatit të pavarur Boiken Abazi kanë konstatuar raste kur janë shpallur fletë votimi të pavlefshme, ose të vlefshme, të cilat më pas kanë kaluar në dengun e fletëve të votimit të subjekteve të tjera politike.
  - 2.4 Nga fotografitë e bëra prej vëzhguesve të akredituar të kandidatit Boiken Abazi dhe nga pamjet filmike janë paraqitur 164 fotografi të fletëve të votimit që kanë nga një "X" të dytë shtesë, ose të tretë, në ato fletë votimi ku është vendosur një "X" për Kandidatin e Pavarur Boiken Abazi.

Boiken Abazi 

2.5 Janë konstatuar raste të shumta të përdorimit të stilolapsit nga ana e grupeve të numërimit mbi tavolinën e numërimit dhe mbi fletët e votimit, duke vendosur shenja në fletët e votimit të cilat ndikojnë te rritja e numrit të votave të pavlefshme.

3. Shkelje që lidhen me procesin e numërimit:

- 3.1 Janë konstatuar me sy nga vëzhguesit raste kur numëruesit kanë kaluar vota për kandidatin e pavarur Boiken Abazi në drejtim të subjekteve të tjera politike.
- 3.2 Përbërja e grupit numërues vetëm nga anëtarë të një subjekti politik, dhe zhvillimi i procesit të numërimit në tavolinën e numërimit në mungesë të anëtarëve të tjerë të grupit të numërimit, duke nxituar çdo procedurë e veprim që lidhet me procesin e numërimit, në shkelje të kodit.
- 3.3 Mbulimi me gisht gjatë procesit të numërimit, i katrorit nën numrin 13 që i përkiste kandidatit të pavarur Boiken Abazi.
- 3.4 Në ekranin e tavolinave të numërimit shpesh nuk është vendosur pamja e plotë e fletës së votimit.
- 3.5 Refuzimi i dhënies së kopjes së procesverbaleve të nënshkruara të rezultateve të numërimit të QV-vë të vëzhguesit të kandidatit të pavarur Boiken Abazi, dhe mos vendosja e këtyre procesverbaleve në hapësirën e përcaktuar nga KZAZ-ja përkatëse në shkelje të dispozitës përcaktuar në Kodin Zgjedhor.
- 3.6 Mungesa e subjektit zgjedhor me nr. 13, kandidati i pavarur Boiken Abazi, në tabelën përmbledhëse të rezultateve të një KZAZ-je.
- 3.7 Në fillim të procesit të numërimit masivisht në KZAZ-të e Qarkut nuk janë treguar në kamera ana e pasme e fletëve të votimit ku gjendet vula.
- 3.8 Nuk janë thënë me zë, si dhe nuk janë paraqitur në kamera të GN (Grupeve të numërimit në tavolinat e numërimit), apo ndonjë formë tjetër të shqeshme: numri i votuesve të QV-së, të fletëve të votimit në kuti/QV), apo edhe numri i fletëve të papërdorura, kodet e sigurisë së kutisë.

4. Mungesa e pamjeve filmike të kamerave 360 gradë për tre KZAZ në Qarkun Tiranë.
5. Ekzistenca e një indicieje që në Shkollën "Arben Broci" në Tiranë mund të jenë hapur kutitë e votimit dhe manipuluar fletët e votimit para se ato të dërgoheshin në Vendin e Numërimit të Votave.
6. Sipas burimeve zyrtare, mbi 17.000 qytetarëve të infektuar me COVID-19 në Qarkun Tiranë, u është mohuar arbitrarisht e drejta kushtetuese për të votuar, dhe KQZ e organet përgjegjëse nuk ndërmorën masa për t'ua mundësuar votimin në spitale apo në vendet ku ishin të karantinuar.
7. Qeveria vendosi arbitrarisht dhe pa paralajmërim masën për karantinë dy javore për qytetarët që ktheheshin nga Greqia dhe Maqedonia e Veriut, duke ndikuar negativisht drejtpërdrejt tek e drejta e votës e këtyre qytetarëve.

Boiken Abazi

8. Konfigurimi i fletës elektronike të votimit që u përdor në ditën e zgjedhjeve në 32 Qendra Votimi në Tiranë, nuk ishte i njëjtë me atë që u demonstrua publikisht në periudhën e testimit para ditës së zgjedhjeve.
9. Ndaj qytetarëve u ushtrua presion, përmes publikimit të një databaze të të dhënave personale të më shumë se 900.000 qytetarëve shqiptarë. Të dhënat personale, të cilat dyshohet se janë të vjedhura, shoqëroheshin nga vlerësime për preferencat politike dhe elektorale të qytetarëve, duke kërcënuar publikisht fshehtësinë e votës, e cila garantohet nga kushtetuta për të gjithë qytetarët. Publikimi i kësaj databaze ka cenuar parimet e përgjithshme të zgjedhjeve dhe përbën një vepër penale që ndikon në procesin zgjedhor.
10. Qytetarëve të Shqipërisë që gjendeshin jashtë shtetit iu mohua e drejta e votës, edhe pse kjo është një e drejtë kushtetuese dhe ligjore, e përcaktuar edhe në ndryshimet e fundit të Kodit Zgjedhor.
11. Keqpërdorimi i punësimeve në masë në administratën publike si dhe i fondeve publike i cili ka patur për synim dhe rezultat ndikimin në rezultatet e zgjedhjeve.

#### **FAKTET ARGUMENTAT, DISPOZITAT LIGJORE KU MBËSHTETET ANKIMIMI**


1. **Shkeljet që lidhen me pengimin e vëzhguesëve të kandidatit të pavarur Boiken Abazi, dhe të vetë kandidatit.**

##### **1.1 Kryetarët e tetëmbëdhjetë (18) KZAZ-ve kanë penguar hyrjen brenda Vendeve të Numërimit të Votave (VNV) përkatëse gjatë kohës së pranimit të kutive në VNV, duke mos i lejuar vëzhguesit të monitorojnë procesin e pranim-dorëzimit të kutive të votimit, në kundërshtim të Kodit Zgjedhor.**

Kjo shkelje konstatohet me anë të dëshmimeve të vëzhguesve të akredituar të Kandidatit të Pavarur Boiken Abazi, si në vijim: Niki Xara (KZAZ 29), Romina Asllanaj dhe Darti Kapaj (KZAZ 39), Elton Brozi (KZAZ 37), Kledi Haxhillari (KZAZ 30), Dejona Mihali (KZAZ 35), Edvin Shehu dhe Arnen Sula (KZAZ 34), Elis Hadarmataj (KZAZ 27), Astrit Xhika (KZAZ 36). Këto dëshmi të vëzhguesve janë bashkëlidhur në cilesinë e provës në Aneksin Nr. 1 të kësaj Ankese.

Në të njëjtën kohë, kjo shkelje vërtetohet nga kamerat 360 gradë (ato që na janë vendosur në dispozicion, pasi ka disa që mungojnë) brenda ambienteve të VNV-e, ku thuajse në të gjitha rastet procesi i pranim-dorëzimit të kutive të votimit ka ndodhur pa praninë e vëzhguesve.

Të njëjtin konstatim për këtë kategori shkeljeje e ka shprehur edhe organizata KRIIK që ka monitoruar me vëzhgues të certifikuar procesin zgjedhor, përmes raportit të saj të datës 25 prill, ora 23:30. (<https://kriik.al/home/2021/04/26/konference-per-shtyp-mbyllja-e-qendrave-te-votimit-dhe-dorezimi-i-materialeve-zgjedhore-dhe-kutive-te-votimit-ne-vnv/>). Në lidhje me pranimin e kutive të votimit në Qendrat e Votimit, raporti shkruan se “KRIIK rikujton se kjo është një praktike jo korrekte, pasi Kodi Zgjedhor përcakton se të gjitha proceset duhet të zhvillohet në prani të vëzhguesve, me një transparence maksimale”.

Boiken Abazi 

Kjo shkelje ngre pikëpyetje serioze mbi gjithë procesin e pranim-dorëzimit të kutive si dhe biesh me Kodin Zgjedhor:

*Neni 7 i Kodit Zgjedhor përcakton "Të drejtat dhe detyrat e vëzhguesve"*

*1. Gjatë kryerjes së detyrave të tyre, vëzhguesit kanë këto të drejta: a) të vëzhgojnë pa pengesë të gjitha aspektet e përgatitjes dhe zhvillimit të zgjedhjeve dhe të gjitha fazat e procesit zgjedhor;*

Shkelja rëndohet edhe më shumë pasi në asnjë moment Grupet e Numërimit nuk bënin publike kodet e sigurisë së kutive të votimit që hapeshin në Vendet e Numërimit të Votave, duke vendosur në pikëpyetje gjithë procesin e administrimit të fletëve të votimit brenda kutive të votimit. Ekziston dyshimi i bazuar mbi argumentet dhe provat e kësaj Ankese se shkelje të tilla janë bërë me synimin për të vendosur shenja "X" të tjera nga Grupet e Numërimit të Votave në fletët e votimit, me synimin për t'ia kaluar partive të tjera ose për t'i shpallur ato të pavlefshme.

**1.2 Pasi kryetarët e KZAZ-vë kanë pranuar kutitë e votimit në VNV, kanë nisur të thërrasin dhe lejojnë hyrjen në VNV në mënyrë arbitrare, vetëm të atyre vëzhguesve që ata kanë përzgjedhur subjektivisht.**


Kjo shkelje vërtetohet me anë të dëshmimeve të vëzhguesve të akredituar të Kandidatit të Pavarur Boiken Abazi, si në vijim: Darti Kapaj (KZAZ 39), Elton Brozi (KZAZ 37), Kledi Haxhillari (KZAZ 30), Dejona Mihali (KZAZ 35), Arnen Sula (KZAZ 34) dhe Edvin Shehu (KZAZ 34). Këto dëshmi të vëzhguesve janë bashkëlidhur në cilesinë e provës në Aneksin Nr. 1 të kësaj Ankese, dhe janë në shkelje të Kodit Zgjedhor:

*Neni 6 "E drejta për të caktuar vëzhgues"*

*1. Çdo parti politike apo kandidat i propozuar nga zgjedhësit, i regjistruar në KQZ si subjekt zgjedhor, ka të drejtë të caktojë nga një vëzhgues në KZAZ, në KQV dhe për çdo tavolinë në Vendin e Numërimit të Votave pas regjistrimit të kandidatit/kandidatëve për zonën zgjedhore përkatëse ose pasi ka paraqitur listë shumemërore..*

Të njëjtën shkelje e ka verifikuar edhe Kandidati i Pavarur Boiken Abazi, siç është shpjeguar në Pikën 1.4 më poshtë në këtë ankesë. Vendime të tilla arbitrare ndikuan më vonë edhe në monitorimin e procesit të numërimit duke vështirësuar vëzhgimin për shumë prej vëzhguesve të akredituar të kandidatit Boiken Abazi, si dhe duke mos lejuar që vëzhguesit e kandidatit Boiken Abazi të jenë të pranishëm gjatë momentit të hapjes së kutive të votimit. Ekziston dyshimi i bazuar mbi argumentet dhe provat e kësaj Ankese se shkelje të tilla janë bërë me synimin për të vendosur shenja "X" të tjera nga Grupet e Numërimit të Votave në fletët e votimit, me synimin për t'ia kaluar partive të tjera ose për t'i shpallur ato të pavlefshme.

**1.3 Brenda VNV-ve as nuk ka pasur e as nuk është zbatuar asnjë rregull për ndarjen e barabartë të hapësirës së monitorimit për vëzhguesit e akredituar. Pozicionimi i vëzhguesëve të kandidatit Boiken Abazi pranë ekraneve dhe tavolinave të numërimit, në shumicën e rasteve është pamundësuar për shkak se kryetarët e KZAZ-ve u jepnin përparësi subjekteve që përzgjidhnin**

Boiken Abazi 

**në mënyrë arbitrare, duke spostuar fizikisht vëzhguesit tanë si dhe duke i kërcënuar me largim nga VNV-të.**

Kjo shkelje vërtetohet me anë të dëshmimeve të vëzhguesve të akredituar të Kandidatit të Pavarur Boiken Abazi, si në vijim: Artiola Shabani dhe Hysamedin Feraj (KZAZ 38), Darti Kapaj dhe Romina Asllanaj (KZAZ 39), Ago Nuhaj (KZAZ 41), Kledi Haxhillari (KZAZ 30), Dejona Mihali (KZAZ 35), Enris Buçka (KZAZ 26), Ditjon Kalemasi (KZAZ 43) Këto dëshmi të vëzhguesve janë bashkëlidhur në cilesinë e provës në Aneksin Nr. 1 të kësaj Ankese.

Gjithashtu, nga raporti i gjetjeve paraprake të OSBE-ODHIR për zgjedhjet e 25 prillit konstatohet se: *“Transparenca e procesit dëmtohej ndonjëherë për shkak të vendosjes së vëzhguesve tepër larg tavolinave të numërimit dhe mosekspozimit të fletëve të votimit nga ekipet e numërimit në kamera për aq kohë sa do të mjaftonte për t’u shqyrtuar nga publiku.”*, duke mbështetur kështu edhe dëshmitë e vëzhguesve të Kandidatit të Pavarur Boiken Abazi.

Në këtë mënyrë janë shkelur disa nene të Kodit Zgjedhor:

*Neni 6 pika 1 “E drejta për të caktuar vëzhgues”*

*1. Çdo parti politike apo kandidat i propozuar nga zgjedhësit, i regjistruar në KQZ si subjekt zgjedhor, ka të drejtë të caktojë nga një vëzhgues në KZAZ, në KQV dhe për çdo tavolinë në*

*Vendin e Numërimit të Votave pas regjistrimit të kandidatit/kandidatëve për zonën zgjedhore përkatëse ose pasi ka paraqitur listë shumemërore..*


*Neni 3 pika 6 “Parime të përgjithshme”*

*Komisionet zgjedhore, të parashikuara në këtë Kod, i përmbushin funksionet e tyre, në përputhje me ligjin, në mënyrë të paanshme dhe transparente.*

Ekziston dyshimi i bazuar mbi argumentet dhe provat e kësaj Ankese se shkelje të tilla janë bërë me synimin që vëzhguesit e kandidati Boiken Abazi të mbaheshin larg nga tavolinat e numërimit në mënyrë që të pengoheshin nga evidentimi i shkeljeve që lidhen me vendosjen e shenjave “X” të tjera nga Grupet e Numërimit të Votave në fletët e votimit, me synimin për t’ia kaluar partive të tjera ose për t’i shpallur ato të pavlefshme. Ky dyshim bazohet edhe mbi provat e paraqitura në pikën 2.5 të kësaj Ankese që lidhet me ndërhyrjen në fletët e votimit gjatë procesit të numërimit si dhe me të gjitha shkeljet e evidentuar në Pikën 3 të kësaj ankese.

**1.4 Policia e Shtetit ka zbatuar urdhra të paligjshëm të dhënë nga kryetarët e KZAV-ve duke penguar hyrjen në VNV të vëzhguesve të akredituar të kandidatit të pavarur Boiken Abazi, si dhe të vetë kandidatit, duke mos qenë e paanshme në kryerjen e detyrave për të garantuar trajtim të barabartë të të gjitha subjekteve politike.**

Kjo shkelje vërtetohet me anë të dëshmimeve të vëzhguesve të akredituar të Kandidatit të Pavarur Boiken Abazi, si në vijim: Darti Kapaj (KZAZ 39), Elton Brozi (KZAZ 37), Kledi Haxhillari (KZAZ 30), Dejona Mihali (KZAZ 35), Arnen Sula dhe Edvin Shehu (KZAZ 34). Këto dëshmi të vëzhguesve janë bashkëlidhur në cilesinë e provës në Aneksin Nr. 1 të kësaj Ankese.

Boiken Abazi 

Për më shumë, edhe kandidati Boiken Abazi ka qenë i pranishëm në datën 26.04.2021 rreth orës 1:00 – 2:00 të mëngjesit, në Vendin e Numërimit të Votave (VNV) në Shkollën “Bajram Curri” në Tiranë, KZAZ 34, kur me urdhër të Kryetarit të KZAZ-së Policia e Shtetit ndalonte hyrjen në VNV të vëzhguesve të akredituar si dhe të kandidatit Boiken Abazi. Për këtë rast ekziston një fotografi (Marrë nga: <https://www.balkanweb.com/boiken-abazi-denoncon-tek-kzaz-nr-34-nuk-po-me-lejojne-asnje-vezhgues-po-bejme-ankese-ne-kas-foto/>) e bërë publike nga kandidati Boiken Abazi në cilësinë e provës, si dhe pamje filmike të bëra publike nga kandidati Boiken Abazi – video është publikuar edhe në internet në portalin me adresën në vijim: <https://www.voal.ch/boiken-abazi-denoncon-vjedhjen-e-votave-dhe-sjelljen-brutale-te-policise-video/>). Rasti është flagrant pasi kandidati dhe vëzhguesit janë ndaluar të hynë në VNV edhe pse tashmë kishte nisur prej së paku një ore procesi i numërimit të votave në VNV.

Këto shkelje bien ndesh me Kodin Zgjedhor si në vijim:

*Neni 121. prg 1, “Personat e pranishëm gjatë procesit të numërimit të votave”*

*1. Gjatë procesit të numërimit të votave, në Vendin e Numërimit të Votave janë të pranishëm vetëm anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së, anëtarët e grupeve të numërimit, kandidatët, vëzhguesit e subjekteve zgjedhore, vëzhgues të tjerë të akredituar, përfaqësuesit e akredituar të medias, si dhe personeli teknik për mbarëvajtjen e sistemit të kamerave, i autorizuar nga KQZ-ja.*

*Neni 3, prg. 7 “Parime të përgjithshme”*

*Policia e Shtetit i ushtron detyrat e veta në shërbim të zgjedhjeve në paanshmëri të plotë ndaj subjekteve zgjedhore. Veprimtaria e saj zhvillohet sipas rregullave të përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore të miratuara nga KQZ-ja.*

Ekziston dyshimi i bazuar mbi argumentet dhe provat e kësaj Ankese se shkelje të tilla janë bërë me synimin që vëzhguesit e akredituar të Kandidatit të Pavarur Boiken Abazi të pengoheshin për të kryer evidentimin e shkeljeve që lidhen me vendosjen e shenjave “X” të tjera nga Grupet e Numërimit të Votave në fletët e votimit, me synimin për t’ia kaluar partive të tjera ose për t’i shpallur ato të pavlefshme. Ky dyshim bazohet edhe mbi provat e paraqitura në pikën 2.5 të kësaj Ankese që lidhet me ndërhyrjen në fletët e votimit gjatë procesit të numërimit. me të gjitha shkeljet e evidentuar në Pikën 3 të kësaj Ankese, si dhe në të gjitha pikat (1.1 - 1.5) të këtij Argumenti.

**1.5 Prania në masë brenda VNV-e të personave të paautorizuar (të paakredituar), përkatësisht familjarë dhe mbështetës të shtabit të kandidatëve të subjekteve të tjera zgjedhore duke shkaktuar tensione, duke ndërhyrë me fjalë e deri te përdorimi i dhunës fizike.**

Kjo shkelje vërtetohet me anë të dëshmimeve të vëzhguesve të akredituar të Kandidatit të Pavarur Boiken Abazi, si në vijim: Adriatik Kurti dhe Niki Xara (KZAZ 29), Ago Nuhaj (KZAZ 41), Xhemal Leti (KZAZ 42), Ditjon Kalemasi (KZAZ 43), Elton Brozi (KZAZ 37), Kledi Haxhillari (KZAZ 30), Dejona Mihali (KZAZ 35), Enris Buçka (KZAZ 26), Elis Hadarmataj (KZAZ 27),

Boiken Abazi 

Astrit Xhika (KZAZ 36). Këto dëshmi të vëzhguesve janë bashkëlidhur në cilesinë e provës në Aneksin Nr. 1 të kësaj Ankese.

E njëjta shkelje konstatohet edhe në raportin (<https://kriik.al/home/2021/04/27/konference-per-shtyp-ecuria-e-procesit-te-numerimit/>) e organizatës KRIIK, të datës 26 prill, ora 22:45, ku shkruhet se: “Nga informacionet e vëzhguesve që ne kemi, ka dyndje të personave të paaautorizuar, madje këtu në qendrën operative kanë ardhur foto dhe video që tregojnë prezencën e personave, të cilët janë pa akreditimin e vendosur në vend të dukshëm dhe tregojnë për një dyndje tejnormale brenda këtyre qendrave.”

Degradimi në dhunë fizike ka ndodhur në datën 26.04.2021 edhe te VNV te Shkolla “1 Maji” në lagjen “Ali Ademi”, KZAZ 30, gjatë numërimit të votave, siç dëshmojnë edhe pamjet filmike të bëra publike nga mediat: <https://www.youtube.com/watch?v=sVHNMELTBi4>. Dhunë fizike në VNV ka patur edhe në KZAZ 43 në Rrogozhonë, siç raportohet edhe nga vëzhguesit tanë, nga mediat (<https://top-channel.tv/video/top-channel-efare-eshte-ajo-arme-aty-banoret-e-zones-frikesohen-nga-sherri-ne-rrogozhine/>) dhe në raportin e organizatës KRIIK i datës 26.04.2021: <https://kriik.al/home/2021/04/27/konference-per-shtyp-ecuria-e-procesit-te-numerimit/>.

Tensioni dhe dhuna e shkaktuar brenda dhe jashtë disa VNV-e në Qarkun Tiranë ka ndikuar drejtpërdrejt tek transparenca, standardet dhe ecuria e procesit të numërimit, duke shkaktuar presion mbi grupet e numërimit dhe vëzhguesit në një nivel të tillë deformues për procesin e numërimit të votave në KZAZ-të ku është zhvilluar dhuna, por njëkohësisht duke krijuar një atmosferë tensioni dhe presioni të shtuar në krejt Qarkun e Tiranës gjatë procesit të numërimit. Pashmangshëm kjo situatë ndikon në mbarëvajtjen normale të procesit të numërimit dhe në rezultatet e numërimit, kur merren parasysh edhe shkeljet që kanë ndodhur në tavolinat e numërimit para dhe pas dhunës.


Shkeljet e evidentuara në këtë pjesë të ankesës janë edhe penale (Kodi Penal) edhe bien ndesh me Kodin Zgjedhor:

*Neni 121, pika 2 “Personat e pranishëm gjatë procesit të numërimit të votave”*

*2. KZAZ-ja merr masa dhe është përgjegjëse për moslejimin e personave të tjerë në Vendin e Numërimit të Votave, përveç atyre të parashikuar në pikën 1 të këtij neni. Në rast të pranishmërisë së personave të tjerë, përveç atyre sipas pikës 1 të këtij neni, KZAZ-ja, me vendim, njofton menjëherë punonjësit e Policisë së Shtetit dhe rasti mbahet shënim në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZAZsë, duke përfshirë edhe orën e saktë të ardhjes dhe largimit të punonjësve të Policisë së Shtetit.*

**2 Shkelje që lidhen me vota të pavlefshme, të cilat, në total, për Qarkun Tiranë kanë qenë 18.422 fletë votimi:**

**2.1 Vendimi për ta shpallur një fletë votimi të pavlefshme ka patur standarde të dyfishta edhe në të njëjtën tavolinë numërimi e në të njëjtën VNV. Standardi ka ndryshuar edhe nga njëra VNV tek tjetra. Në të njëjtën tavolinë numërimi, vota për kandidatin e pavarur shpallej e pavlefshme nëse kishte një shënim diku në cep të fletës së votimit, por nuk shpallej e pavlefshme në**

Boiken Abazi 



**rastin kur shenja të ngjashme në cep të fletës së votimit i përkiste një subjekti tjetër politik.**

Kjo shkelje konstatohet përmes dëshmimeve të vëzhguesve të akredituar të Kandidatit të Pavarur Boiken Abazi, si në vijim: Dejona Mihali (KZAZ 35), Andi Hasani (KZAZ 28). Këto dëshmi të vëzhguesve janë bashkëlidhur në cilesinë e provës në Aneksin Nr. 1 të kësaj Ankese.

Secila KZAZ dhe secila tavolinë numërimi nëpër VNV ka vepruar në mënyrë autonome duke mos iu përmbajtur një standardi unik në lidhje me përcaktimin e pavlefshmërisë së votës. Standardi ndryshonte dhe caktohej shpesh atypëraty në diskutime mes anëtarëve të Grupeve të Numërimit, duke ndikuar drejtpërdrejt tek rezultatet. Ky fenomen vërehet në disa nga pamjet filmike të VNV-ve në Qarkun Tiranë.

Për një proces të rregullt, Kodi ka caktuar parimet pazë mbi të cilat duhet të mbështetet adminstrmi i zgjedhjeve, siç parashikohet në ligj, në mënyrë të veçantë të kërkesave për legjitimitet, transparencë, paanshmëri, profesionalizëm dhe në mënyrë të pavarur të anëtarëve të komisioneve zgjedhore dhe të anëtarëve të GNV, gjatë kryerjes së detyrës.

Nenet e Kodit që shkelen nga ky rast:

*Neni 117 "Llojet e votave dhe kriteret për vlerësimin e votës"*

*4. Vlerësimi i votave synon të identifikojë, sa të jetë e mundur, qëllimin e zgjedhësit. Në zbatim të këtij neni, KQZ-ja përgatit udhëzues të veçantë për të lehtësuar punën dhe unifikuar praktikën e vlerësimit të fletëve nga ana e komisioneve dhe personave të ngarkuar nga ky Kod për numërimin dhe vlerësimin e votave.*

*Vendim nr. 20 date 20.04.2021 të Komisionit Rregullator "Për miratimin e udhëzuesit të punës të komisionit të zonës së administrimit të zgjedhjeve dhe grupit të numërimit të votave për zgjedhjet për kuvendin e shqipërisë, të datës 25 prill 2021"*

**2.2 Vëzhguesit e kandidatit të pavarur Boiken Abazi kanë konstatuar raste kur janë shpallur shumë fletë votimi të pavlefshme pa asnjë arsytim, dhe kontestimet e atypëratyshme nga vëzhguesit e kandidatit të pavarur Boiken Abazi nuk janë marrë parasysh nga grupi i numërimit dhe kryetari i KZAZ-së përkatëse.**

Kjo shkelje konstatohet me anë të dëshmimeve të vëzhguesve të akredituar të Kandidatit të Pavarur Boiken Abazi, si në vijim: Adriatik Kurti dhe Niki Xara (KZAZ 29), Dejona Mihali (KZAZ 35), Andi Hasani (KZAZ 28). Këto dëshmi të vëzhguesve janë bashkëlidhur në cilesinë e provës në Aneksin Nr. 1 të kësaj Ankese.

Në shkelje të Kodit Zgjedhor dhe të rregulloreve, në shumicën e rasteve kur ngriheshin shqetësime nga vëzhguesit e Kandidatit të Pavarur Boiken Abazi në lidhje me shkelje të evidentuara gjatë procesit të numërimit të votave, Komisionerët, kryetarët dhe/ose nënkryetarët e KZAZ-ve i kërcënonin vëzhguesit e kandidatit Boiken Abazi me largimin prej ambienteve të VNV-e.

Boiken Abazi 

**2.3 Vëzhguesit e kandidatit të pavarur Boiken Abazi kanë konstatuar raste kur janë shpallur fletë votimi të pavlefshme, ose të vlefshme, të cilat më pas kanë kaluar në dengun e fletëve të votimit të subjekteve të tjera politike.**

Kjo shkelje vërtetohet me anë të dëshmive të vëzhguesve të akredituar të Kandidatit të Pavarur Boiken Abazi, si në vijim: Kledi Haxhillari (KZAZ 30), Dejana Mihali (KZAZ 35). Këto dëshmi të vëzhguesve janë bashkëlidhur në cilesinë e provës në Aneksin Nr. 1 të kësaj Ankese.


Gjatë evidentimit të këtyre shkeljeve, dhe në shpërputhje me Kodin Zgjedhor dhe udhëzimet, në shumicën e rasteve kur ngriheshin shqetësime nga vëzhguesit e Kandidatit të Pavarur Boiken Abazi gjatë procesit të numërimit të votave, Komisionerët, kryetarët dhe/ose nënkryetarët e KZAZ-ve i kërcënonin vëzhguesit e kandidatit Boiken Abazi me largimin prej ambienteve të VNV-e. Duke qenë se gjatë procesit të numërimit nuk thuheshin me zë (shiko Pikën 3.9) numri i votave të pavlefshme në fillim dhe në fund të procesit, praktika të tilla pashmangshëm çojnë në deformimin e rezultateve, dhe bien ndesh me Kodin Zgjedhor, me përgjegjësi penale.

**2.4 Nga fotografitë e bëra prej vëzhguesve të akredituar të kandidatit Boiken Abazi dhe nga pamjet filmike janë paraqitur 164 fotografi të fletëve të votimit që kanë nga një "X" të dytë shtesë, ose të tretë, në ato fletë votimi ku është vendosur një "X" për Kandidatin e Pavarur Boiken Abazi.**

Bashkëngjitur kësaj ankese në Aneksin 2 janë vendosur 164 fotografi fletësh votimi të nxjerra nga dokumentimi me fotografi i procesit të numërimit nga vëzhguesit e akredituar të Kandidatit të Pavarur Boiken Abazi, si dhe nga pamjet filmike të siguruar nga KQZ-ja nga kamerat në Vendet e Numërimit të Votave. Ekipi i Kandidatit të Pavarur Boiken Abazi ka mundur të analizojë vetëm një pjesë tejet të vogël të pamjeve filmike të siguruar nga KQZ për procesin e numërimit. Vetëm për Qarkun Tiranë janë 4589 orë videohirime, pa marrë parasysh pamjet filmike që mungojnë – siç shpjegohet në Argumentin 4 të kësaj Ankese (më poshtë). Ekipi i kandidatit Boiken Abazi ka mundur të analizojë rreth 300 orë videohirime nga pamjet filmike të siguruar nga KQZ (që në total janë 4589 orë). Për t'i analizuar nga afër këto pamje filmike kemi patur në dispozicion rreth 8 ditë – një kohë tepër e shkurtër për një material kaq voluminoz. Megjithatë, vetëm nga një përqindje e vogël e analizuar e pamjeve filmike, janë gjetur shumë të dhëna që evidentojnë se shkelja është sistematike, e paramenduar dhe e përhapur masivisht.

Shumica e rasteve të sipërpërmendura nga 164 fletë votimi të fotografuara janë të lidhura me një "X" të dytë shtesë të Partia Socialiste (129 raste nga 164 fletë votimi të fotografuara), si dhe me një "X" të dytë shtesë të Partia Demokratike (28 raste nga 164 fletë votimi të fotografuara).

Fotografitë e fletëve të votimit janë siguruar gjatë procesit të numërimit nga vëzhguesit e akredituar të kandidatit Boiken Abazi si dhe nga pamjet filmike të procesit të numërimit, të siguruar nga KQZ-ja për Qarkun Tiranë. Ato përfshijnë këto Qendra Votimi: QV 1918/3, QV 1918/2, QV 1910, QV 1900/3, QV 1899/1, QV 1898, QV 1896, QV 1891/1, QV 1890, QV 1889, QV 1888, QV 1887/2, QV 1886/1, QV 1885/2, QV 1883, QV 1882/1, QV 1612, QV 1609, QV


Boiken Abazi 

1608/1, QV 1607, QV 1606, QV 1603, QV 1602, QV 2142, QV 1701, QV 1699, QV 1565, QV 1572/2, QV 1573/2, QV 1573/4, QV 1574/1, QV 1576/1, QV 1578, QV 1581/2, QV 1583, QV 1586/1, QV 1587, QV 1588/2, QV 1592/1, QV 1596/1, QV 1597/2, QV 1598/1, QV 1529, QV 1529/1, QV 1529/2, QV 1530, QV 1531, QV 1532, QV 1532/1, QV 1533, QV 1534, QV 1535, QV 1536/1, QV 1536/2, QV 1537, QV 1537/11, QV 1537/12, QV 1537/16, QV 1537/5, QV 1538, QV 1539/1, QV 1539/2, QV 1540, QV 1543, QV 1544, QV 1633, QV 1645, QV 1648, QV 1649, QV 1650, QV 2069, QV 2071, QV 2076, QV 2091, QV 2094, QV 2103, QV 2104, QV 2116, QV 2120.

Për më tepër, në Aneksin 3 të kësaj Ankese janë vendosur edhe tre fotografi të tjera fletësh votimi: dy nga procesi i numërimit të votave në Qarkun Gjirokastrë (QV 4395/1) dhe një nga procesi i numërimit të votave nga Qarku Lezhë (QV 0680). Në këto tre fotografi të dy qarqeve të tjera vërehet qartë se ka një "X" të dytë të vendosur shtesë, përveç shenjës "X" të vendosur në subjektin zgjedhor me numërt 13 (Kandidat i Pavarur).

Evidentimi në masë i fletëve të votimit me një "X" të subjekti zgjedhor "Kandidat i Pavarur" dhe një "X" të një tjetër subjekt zgjedhor nuk mund të jetë thjesht një pasojë rastërore e procesit, e as thjesht gabim njerëzor.

- a. Së pari, fletët e votimit me nga një "X" për dy ose më shumë subjekte zgjedhore janë fenomen i përhapur në të gjithë Qarkun e Tiranës, siç dëshmojnë edhe fotografitë e fletëve të votimit në Aneksin 2.
- b. Së dyti, në shumë prej këtyre fotografive vërehet se ngjyra e bojës së stilolapsit të përdorur për vendosjen e "X"-t të dytë ose të tretë në fletën e votimit ndryshon në tonalitet nga ngjyra e përdorur për "X"-n e vendosur për subjektin zgjedhor me numrin 13, si dhe bashkë me ngjyrën ndryshon edhe forma e "X"-t të dytë ose të tretë të vendosur në fletën e votimit.
- c. Së treti, ka një argument të qëndrueshëm që përforcon bindjen se fletët e votimit që kanë një "X" për subjektin zgjedhor Kandidati i Pavarur Boiken Aabazi me nr 13, si dhe një tjetër "X" për një tjetër subjekt zgjedhor, janë deformuar me qëllim. Ky argument lidhet me faktin se "X" i dytë është vendosur thujse në të gjitha rastet te një nga dy subjektet kryesore parlamentare (Kryesisht te PS, por edhe te PD), pra te ato subjekte politike që kishin komisionerë dhe anëtarë në Grupet Numëruese në VNV. Vota me një "X" të dytë për subjekte zgjedhore të reja, apo të vogla, që nuk kishin komisionerë dhe/ose anëtarë në Grupet e Numërimit, janë thujse inekzistente. Ky argument përforcon bindjen se deformimi i votës me një "X" të dytë për një tjetër subjekt zgjedhor, për t'i vjedhur votat apo për t'i shpallur të pavlefshme votat e Kandidatit të Pavarur Boiken Abazi, është bërë në bashkëpunim mes anëtarëve të Grupeve të Numërimit dhe KZAZ-ve.
- ç. Së fundmi, fakti që e njëjta problematikë, me dy ose më shumë shenja "X", shfaqet edhe në Qarkun Gjirokastrë dhe në Qarkun e Lezhës, dëshmon se kemi të bëjmë me një fenomen sistemik të planifikuar, dhe jo sporadik, i përhapur në të gjithë territorin e vendit por me pasoja më të mëdha në Qarkun Tiranë, aty ku numri i fletëve të votimit të shpallura të pavlefshme është 18.422. Kujtojmë se në Qarkun e Gjirokastrës secili subjekt zgjedhor kishte 6 kandidatë në listë, ndërsa në Lezhë 9.

 Boiken Abazi

Është e qartë se jemi përpara faktit që fletët e votimit janë deformuar në mënyrë të qëllimshme dhe me paramendim, jo nga qytetarët, por nga ata që kanë administruar procesin zgjedhor, duke ndikuar drejtpërdrejt dhe masivisht në rezultatet përfundimtare.

Për më shumë, kjo konstatohet edhe me anë të dëshmive të vëzhguesve të akredituar të Kandidatit të Pavarur Boiken Abazi, si në vijim: Adriatik Kurti (KZAZ 29), Astrit Xhika (KZAZ 36), Artiola Shabani dhe Hysamedin Feraj (KZAZ 38), Darti Kapaj dhe Romina Asllanaj (KZAZ 39), Kledi Haxhillari (KZAZ 30), Xhemal Leti (KZAZ 42), Dejona Mihali (KZAZ 35), Andi Hasani (KZAZ 38), Edvin Shehu (KZAZ 34). Këto dëshmi të vëzhguesve janë bashkëlidhur në cilësinë e provës në Aneksin Nr. 1 të kësaj Ankese.

Në deklaratat publike të përfaqësuesve të KQZ-së është thënë se do të ketë ekspertizë për votat e shpallura të pavlefshme, mirëpo deri tani nuk kemi parë ndonjë veprim të ndërmarrë në këtë drejtim, në përputhje me Nenin 139 të Kodit Zgjedhor. Kandidati i Pavarur Boiken Abazi i mbështet të gjitha masat e KQZ-së të cilat çojnë në verifikimin përmes ekspertimeve të parashikuara në Kod.


**2.5 Janë konstatuar raste të shumta të përdorimit të stilolapsit nga ana e grupeve të numërimit mbi tavolinën e numërimit dhe mbi fletët e votimit, duke vendosur shenja në fletët e votimit të cilat ndikojnë te rritja e numrit të votave të pavlefshme.**

Mediat kanë paraqitur me pamje filmike (<https://www.youtube.com/watch?v=3UXbvZzsR4s>) rastin e një anëtareje të një Grupi Numërues në KZAZ-n në Tiranë e cila me stilolaps në dorë vendos shenja mbi fletët e votimit në shkelje flagrante të Kodit Zgjedhor.

Për më shumë, kjo shkelje konstatohet edhe me anë të dëshmive të vëzhguesve të akredituar të Kandidatit të Pavarur Boiken Abazi, si në vijim: Ersa Prifti (KZAZ 41), Xhemal Leti (KZAZ 42), Dejona Mihali (KZAZ 35), Andi Hasani (KZAZ 38). Këto dëshmi të vëzhguesve janë bashkëlidhur në cilësinë e provës në Aneksin Nr. 1 të kësaj Ankese.

Mbajtja e stilolapsit në dorë nga anëtarët e Grupeve të Numërimit në VNV-të e Qarkut Tiranë është lehtësisht e dallueshme në pamjet filmike të shumicës së tavolinave të numërimit, duke u dhënë mundësinë anëtarëve të Grupeve të Numërimit që ta keqpërdorin stilolapsin sipas rastit mbi fletët e votimit. Kjo shkelje vërteton se fletët e votimit janë manipuluar gjatë procesit të numërimit të votave brenda VNV-e, si dhe që për këtë lloj manipulimi ka ekzistuar një miratim në heshtje mes anëtarëve të Grupeve të Numërimit dhe anëtarëve të KZAZ-ve. Kjo shkelje minon gjithë procesin e numërimit në një KZAZ.

Konsumimi i veprave të tilla penale e minojnë gjithë procesin zgjedhor në Qarkun Tiranë (dhe jo vetëm) duke rrënuar çdo parim dhe standard që lidhet me procesin zgjedhor. Për më tepër, sot e kësaj dite, edhe pse raste të tilla janë bërë publike nuk ka asnjë informacion mbi masat e marra për ata persona që kanë kryer këto vepra. Mbase ata tashmë kanë marrë edhe shpërblimin nga institucionet e shtetit për “punën” e kryer gjatë procesit të numërimit. Mosveprimi, rrënon

Boiken Abazi 

reputacionin dhe besueshmërinë e organeve kompetente që duhet të merren me ndjekjen e rasteve të tilla.

### 3 Shkelje që lidhen me procesin e numërimit:

#### 3.1 Janë konstatuar me sy nga vëzhguesit raste kur numëruesit kanë kaluar vota të vlefshme për Kandidatin e Pavarur Boiken Abazi në drejtim të subjekteve të tjera politike.

Kjo shkelje vërtetohet me anë të dëshmimeve të vëzhguesve të akredituar të Kandidatit të Pavarur Boiken Abazi, si në vijim: Adriatik Kurti dhe Niki Xara (KZAZ 29), Dejana Mihali (KZAZ 35), Andi Hasani (KZAZ 28). Këto dëshmi të vëzhguesve janë bashkëlidhur në cilesinë e provës në Aneksin Nr. 1 të kësaj Ankese.

Nga pamjet filmike të monitoruara nga ekipi i Kandidatit Boiken Abazi, janë evituar raste kur vota ka qenë e qartësisht e vlefshme por nuk është numëruar, si në vijim: QV 1607 (2 vota), QV 1894/1 (1 votë), QV 1901 (1 votë), QV 1902/2 (5 vota), QV 1918/3 (1 votë), QV 1919 (1 votë), QV 2118 (1 votë), QV 1539/1 (1 votë), QV 1539/2 (1 votë), QV 1537/4 (3 vota), QV 2119 (1 votë), QV 1739 (1 votë).


Duhet patur parasysh se votat për Kandidatin e Pavarur Boiken Abazi kanë qenë të shtrira thuajse në të gjithë hapësirën gjeografike të Qarkut Tiranë, dhe nuk kanë qenë të përqëndruara vetëm në disa QV. Siç, kemi shpjeguar edhe më lart në këtë Ankese, koha që kemi patur në dispozicion ka qenë tejet e shkurtër për të monitoruar 4589 orë videozhirime të siguruara nga KQZ-ja. Mënyra se si është vepruar për të kryer monitorimin e pamjeve filmike është përmes kampionimit rastësor të tyre dhe indiciet prej vëzhguesve tanë. Marrë parasysh kampionimin rastësor, dhe shtrirjen e gjerë të votës për Kandidatin Boiken Abazi në Qarkun e Tiranës, dëmi që është bërë përmes këtyre shkeljeve ka ndikuar pa asnjë mëdyshje te rezultati përfundimtar, veçanërisht kur llogaritet edhe dëmi nga votat e deformatuara atypëraty për t'i shpallur të pavlefshme si dhe argumentet e tjera në vijim të kësaj Ankese që kanë ndikuar te rezultati përfundimtar, dhe potencialisht edhe te mandati.

#### 3.2 Përbërja e grupit numëruar vetëm nga anëtarë të një subjekti politik, dhe zhvillimi i procesit të numërimit në tavolinën e numërimit në mungesë të anëtarëve të tjerë të grupit të numërimit, duke nxituar çdo procedurë e veprim që lidhet me procesin e numërimit, në shkelje të kodit.

Kjo shkelje vërtetohet me anë të dëshmisë së vëzhgueses të akredituar të Kandidatit të Pavarur Boiken Abazi, Dejana Mihali (KZAZ 35). Dëshmia e vëzhgueses është bashkëlidhur në cilesinë e provës në Aneksin Nr. 1 të kësaj Ankese. Në bazë të Kodit Zgjedhor:

*Neni 95 pika 2 "Ngritja e Grupeve të Numërimit të Votave (GNV)"*

*2. Grupet e numërimit të votave përbëhen nga katër anëtarë, ku në çdo rast një anëtar emërohet pas propozimit të partisë politike, së cilës i përket kryetari i KZAZ-së, një anëtar pas propozimit*

Boiken Abazi 

të partisë që i përket nënkryetari, ndërsa anëtar i tretë propozohet nga partitë e shumicës qeverisëse dhe anëtar i katërt emërohet pas propozimit të partive të opozitës që kanë të drejtë të 65 propozojnë anëtarë të GNV-ve për ZAZ-të respektive, sipas procedurës së parashikuar në nenin 96 të këtij Kodi.

Vendim nr. 20 date 20.04.2021 të Komisionit Rregullator "Për miratimin e udhëzuesit të punës të komisionit të zonës së administrimit të zgjedhjeve dhe grupit të numërimit të votave për zgjedhjet për kuvendin e shqipërisë, të datës 25 prill 2021" sipas së cilit Çdo Grup Numërimi përbëhet nga numëruesi i parë, sekretari dhe 2 anëtarë. Numëruesi i parë është /propozohet nga i: Partisë Socialiste në KZAZ-të me numër tek, ku kryetari KZAZ-së është i PD, ndërsa Partisë Demokratike në KZAZ-të me numër çift, ku kryetari KZAZ-së është i PS.

Numëruesi i parë është i përkatësisë politike të kundërt me sekretarin e GNV.

Shkelje të tilla e minojnë të gjithë procesin e numërimit për cilëndo QV, apo tavolinë numërimi.

### **3.3 Mbulimi me gisht gjatë procesit të numërimit, i katrorit nën numrin 13 që i përkiste kandidatit të pavarur Boiken Abazi.**


Kjo shkelje vërtetohet me anë të dëshmive të vëzhguesve të akredituar të Kandidatit të Pavarur Boiken Abazi, si në vijim: Adriatik Kurti (KZAZ 29), Ersja Prifti dhe Ago Nuhaj (KZAZ 41), Xhemal Leti (KZAZ 42), Dejona Mihali (KZAZ 35), Armen Sula (KZAZ 34). Këto dëshmi të vëzhguesve janë bashkëlidhur në cilesinë e provës në Aneksin Nr. 1 të kësaj Ankese.

Në shumë raste kur vëzhguesit e akredituar të Kandidatit të Pavarur Boiken Abazi janë ankuar në KZAZ për këtë shkelje, ata ose janë injoruar ose janë kërcënuar me largimin nga ambientet e VNV-së.

Për më tepër, janë të shumta rastet e vërejtura gjatë pamjeve filmike të siguruara nga KQZ-ja, ku gishti i anëtarit të Grupit Numërues mbulon numrin 13 dhe katrorin e subjektit zgjedhor Kandidati i Pavarur Boiken Abazi. 19 (nëntëmbëdhjetë) fotografi për ta ilustruar këtë shkelje janë paraqitur edhe në Aneksin nr. 4 të kësaj Ankese, të marra nga pamjet filmike nga numërimi i QV 1587, QV 2111, QV 1573, etj. Vlen për t'u nënvizuar se këto raste janë thjesht ilustruese, pasi kjo shkelje ka qenë e përhapur masivisht në një pjesë të konsiderueshme të tavolinave të numërimit në VNV-të e Qarkut Tiranë – kjo mund të konstatohet lehtësisht nga personeli i KQZ / KAS, duke ndikuar kështu jo vetëm tek ulja e transparencës dhe besueshmërisë, por marrë parasysh edhe vjedhjen dhe deformimin e votës të konstatuar në këtë ankesë, shkelje të tilla kanë synimin të ndikojnë drejtpërdrejt te rezultati përfundimtar.

### **3.4 Në ekranin e tavolinave të numërimit nuk është vendosur pamja e plotë e fletës së votimit.**

Kjo shkelje vërtetohet me anë të dëshmive të vëzhguesve të akredituar të Kandidatit të Pavarur Boiken Abazi, si në vijim: Elton Brozi (KZAZ 37), Artiola Shabani dhe Hysamedin Feraj

Boiken Abazi 

(KZAZ 38), Erlis Hajdarmataj (KZAZ 27), Ersja Prifti (KZAZ 41), Xhemal Leti (KZAZ 42) Dejona Mihali (KZAZ 35), Astrit Xhika (KZAZ 36). Këto dëshmi të vëzhguesve janë bashkëlidhur në cilesinë e provës në Aneksin Nr. 1 të kësaj Ankese.

Shkelje të tilla janë konstatuar në disa raste edhe gjatë monitorimit të pamjeve filmike të siguruara nga KQZ për Qarkun Tiranë.

**3.5 Refuzimi i dhënies së kopjes së procesverbaleve të nënshkruara të rezultateve të numërimit të QV-vë të vëzhguesit të kandidatit të pavarur Boiken Abazi, dhe mos vendosja e këtyre procesverbaleve në hapësirën e përcaktuar nga KZAZ-ja përkatëse në shkelje të dispozitës përcaktuar në Kodin Zgjedhor.**

Kjo shkelje konstatohet me anë të dëshmimeve të vëzhguesve të akredituar të Kandidatit të Pavarur Boiken Abazi, si në vijim: Adriatik Kurti (KZAZ 29) Artiola Shabani (KZAZ 38), Dejona Mihali (KZAZ 35), Andi Hasani (KZAZ 28) Edvin Shehu (KZAZ 34). Këto dëshmi të vëzhguesve janë bashkëlidhur në cilesinë e provës në Aneksin Nr. 1 të kësaj Ankese.

Kjo shkelje bie ndesh me Kodin Zgjedhor:

*Neni 122 pika 4 "Nxjerrja e tabelës përmbledhëse të rezultatit të zgjedhjeve nga KZAZ"*

*4. Kopje të Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve të Zgjedhjeve të ZAZ-së, tabelave të rezultateve të qendrave të votimit dhe kopje të Procesverbalit të Konstatimit u jepen anëtarëve të KZAZ-së dhe vëzhguesve të subjekteve zgjedhore, ndërsa origjinalet e tyre, vulat dhe çdo material tjetër zgjedhor dorëzohen në KQZ.*

Shkelje të tilla ngrejné dyshimin e bazuar, përmes mungesës së transparencës nga ana e KZAZ-ve dhe Grupeve të Numërimit, se rezultatet janë shtrembëruar gjatë procesit të numërimit nëpër VNV. E kombinuar me të gjitha shkeljet e tjera të evidentuara në këtë Ankesë, ky konstatim çon pashmangshëm drejt përfundimit se akte të tilla kanë qenë të qëllimshme dhe të paramenduara, me synimin për të cenuar gjithë procesin zgjedhor në favor të partive më të mëdha parlamentare.

**3.6 Mungesa e subjektit zgjedhor me nr. 13, kandidati i pavarur Boiken Abazi, në tabelën përmbledhëse të rezultateve të një KZAZ-je.**

Kjo shkelje vërtetohet me anë të dëshmimeve të vëzhguesve të akredituar të Kandidatit të Pavarur Boiken Abazi, si në vijim: Artiola Shabani (KZAZ 38). Këto dëshmi të vëzhguesve janë bashkëlidhur në cilesinë e provës në Aneksin Nr. 1 të kësaj Ankese.

Për më shumë, edhe Kandidati Boiken Abazi ka qenë i pranishëm në ambientet e brendshme të KZAZ-së 38, "Shkolla e Kuqe" në Tiranë, nga ku ka dhënë edhe një intervistë për media (<https://www.oranews.tv/vendi/abazi-akuzon-ps-votat-e-mia-po-i-shpallin-te-pavlefshme-nuk-mjaftoi-patron-i797283>) dhe ka bërë publike dy procesverbalet e tabelave përmbledhëse të rezultateve të KZAZ-së numër 38, ku të njërit janë përlllogaritur votat e marra për subjektin zgjedhor me numër 13 në fletëvotim, ndërsa tek tjetri jo. Të dy këto janë tabela të nxjerra nga sistemi i KZAZ-së nr. 38 në Tiranë. Fotografitë e këtyre dy tabelave përmbledhëse të rezultateve janë vendosur bashkëlidhur kësaj Ankese në Aneksin nr. 5.

Boiken Abazi 

**3.7 Në fillim të procesit të numërimit masivisht në KZAZ-të e Qarkut Tiranë nuk janë treguar në kamera pjesët e pasme të fletëve të votimit ku ndodhet vula.**

Kjo shkelje vërtetohet me anë të pamjeve filmike që janë monitoruar deri tani nga materiali që i është vendosur në dispozicion Kandidatit të Pavarur Boiken Abazi nga KQZ-ja. Në një pjesë të konsiderueshme të tavolinave të numërimit nuk është ndjekur procedura e parashikuar në Kodin Zgjedhor dhe manualin e udhëzimeve të KQZ-së. Kjo shkelje është lehtësisht e verifikueshme nga KQZ/KAS që i disponon pamjet filmike. Në këtë mënyrë, bëhet e pamundur evidentimi i vulave që dëshmojnë se fletët e votimit kanë qenë të rregullta, dhe se nuk janë futur në një moment të dytë nëpër kutitë e votimit. Ky dyshim përforcohet edhe nga të gjitha shkeljet e tjera të evidentuara në argumentet 1 deri në 3 të kësaj Ankese.

**3.8 Nuk janë thënë me zë, si dhe nuk janë paraqitur në kamera të GN (Grupeve të numërimit në tavolinat e numërimit), apo ndonjë formë tjetër të shqeshme: numri i votuesve të QV-së, të fletëve të votimit në kuti/QV), apo edhe numri i fletëve të papërdorura, kodet e sigurisë së kutisë.**

Shumica e vëzhguesve të akredituar të Kandidatit të Pavarur Boiken Abazi, kanë konstatuar se Grupet e Numërimit nuk i kanë bërë të dukshme kodet e sigurisë, dhe as nuk i kanë lexuar ato me zë. Në të njëjtën mënyrë kanë vepruar edhe për numrin e fletëve të votimit dhe numrin e votuesve në një QV, duke mos treguar publikisht të dhënat para dhe gjatë procesit të numërimit.


Neni 116 (Numërimi i votave) e sqaron qartë se si duhet të evidentohet numri i fletëve të vlefshme, kodet e sigurisë për çdo kuti votimi që Grupi i Numërimit merr në shqyrtim dhe bën gati për ta numëruar:

*6. Fletët e votimit të stivuara numërohen nga numëruesi i parë, i cili, në përfundim të numërimit, ia bën të ditur shifrën anëtarëve të grupit dhe vëzhguesve të subjekteve zgjedhore. Shifra e deklaruar verifikohet me shifrën për pjesëmarrjen e zgjedhësve të shënuar në Procesverbalin e Mbylljes së Votimit. Nëse shifrat nuk përputhen ose nëse kërkohet nga ndonjë prej anëtarëve të Grupit të Numërimit, numëruesi i parë është i detyruar të rifillojë edhe një herë numërimin e fletëve të votimit.*

Duke eliminuar transparencën dhe të dhënat bazë të procesit të numërimit të votave, shkelje të tilla flagrante ia kanë hapur rrugën një manipulimi industrial të votës gjatë procesit të numërimit.

**4 Mungesa e pamjeve filmike të kamerave 360 gradë për tre KZAZ në Qarkun Tiranë.**

Në datën 28.04.2021, kandidati i pavarur Boiken Abazi ka depozituar në KQZ kërkesën me numër prot. 4651, për vënien në dispozicion të materialeve filmike të pamjeve të Vendeve të Numërimit të Votava për KZAZ-të me numër: 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38,

Boiken Abazi 



39, 41, 42, 43. Nga KQZ-ja pamjet e kërkuara, me disa mungesa, na janë dhënë në datën 30.04.2021.

Në dëgjesën publike të mbajtur nga KQZ në datën 04.05.2021 në lidhje me vendimin nr. 343 “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse për rezultatin e votimit në zonën zgjedhore Qarku Tiranë, për subjektet zgjedhore dhe kandidatët për deputetë në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021”, kandidati i pavarur Boiken Abazi ka shprehur (Marrë nga Report TV: <https://www.youtube.com/watch?v=nF-9NjW8qA>) fakte që lidhen me shkelje gjatë procesit zgjedhor, por ndër të tjera ka ngritur publikisht edhe pyetjen ndaj KQZ-së në lidhje me mungesën e pamjeve filmike për kamerat 360 gradë për KZAZ-të në vijim:


- i. KZAZ nr. 31, mungojnë pamjet filmike të kamerës 360 gradë, nga data 26.04.2021, prej orës 17:00 e deri në pëfundim të procesit.
- ii. KZAZ nr. 33, mungojnë pamjet filmike të kamerës 360 gradë, nga data 26.04.2021, prej orës 02:00 (të mëngjesit) e deri në pëfundim të procesit.
- iii. KZAZ nr. 39, mungojnë të gjitha pamjet filmike të kamerës 360 gradë.

Pas dëgjesës publike, kandidati i pavarur Boiken Abazi u kontaktua me telefon nga Drejtori Teknik i KQZ-së për të marrë më shumë informacion mbi mungesën e këtyre pamjeve filmike. Kandidati i pavarur ia komunikoj Drejtorit Teknik edhe me shkrim, përmes telefonit, informacionin mbi pamjet filmike që mungonin nga tre KZAZ-të. Abazi u njoftua nga Drejtori Teknik se nuk i disponin ende ato pamje dhe se do ia vendosnin në dispozicion me t’i patur në KQZ. Përfaqësues të kandidatit Boiken Abazi janë paraqitur sërish në KQZ në datën 7.05.2021 për të pyetur për këto pamje filmike që mungonin, dhe sërish iu është komunikuar se KQZ ende nuk i dispononte. Ende sot, kandidatit të pavarur Boiken Abazi nuk i janë vendosur në dispozicion këto pamje filmike, dhe nuk ka marrë nga KQZ-ja një përgjigje zyrtare për mungesën e këtyre pamjeve.

Kjo situatë bie ndesh me parashikimet e Kodit Zgjedhor, Neni 94, prg. 4. Në mungesë të pamjeve filmike 360 gradë për tre KZAZ-të e sipërpërmendura në Qarkun Tiranë, bëhet e pamundur zbatimi i Nenit 22, prg. 2 i Kodit Zgjedhor, i cili përcakton videomonitorimin për VNV-të “për të monitoruar dhe provuar rregullshmërinë e procesit në mjediset e brendshme të tyre.” Marrë parasysh të gjitha shkeljet e sipërpërmendura në këtë ankesë, si dhe ato në vijim, mungesa e këtyre pamjeve filmike vëndos në pikëpyetje jo vetëm transparencën e procesit të numërimit por edhe vetë rezultatet e këtyre tre KZAZ-ve të qarkut Tiranë.

**5 Ekzistenca e një indicieje që në Shkollën “Arben Broci” në Tiranë mund të jenë hapur kutitë e votimit dhe manipuluar fletët e votimit para se ato të dërgoheshin në Vendin e Numërimit të Votave.**

Nga informacioni dhe një fotografi që qarkullon në rrjetet sociale (bashkëngjitur kësaj ankese në Ankesin nr. 6) një vajzë maturanante e Shkollës “Arben Broci” në Tiranë ka gjetur në korridorin e shkollës paraditen e ditës së hënë, data 26 prill 2021, një fletë votimi zyrtare që kishte një “X” të vendosur poshtë numrit 13, te kandidati i pavarur Boiken Abazi. Kjo fletë votimi i përkët Qendrës së Votimit (QV) 1907 / 1 (siç dallohet qartë edhe nga numri i QV-së në fotografinë e vendosur në Ankesin e kësaj ankese). Duke qenë se kandidati i pavaruar Boiken Abazi nuk ka patur të drejtën për të caktuar komisionerë në këtë QV, si dhe marrë parasysh që Kandidati

Boiken Abazi 


Boiken Abazi nuk ka patur vëzhgues të akredituar për të këtë QV, ekziston dyshimi i bazuar se kutia e votimit e kësaj QV-je mund të jetë manipuluar bashkë me fletët e votimit brenda ambienteve të shkollës "Arben Broci". Për të sqaruar këtë rast, kërkohet verifikimi i pamjeve filmike të QV-së përkatëse si dhe të ambienteve të Shkollës "Arben Broci" gjatë datës 25 dhe 26 prill 2021. Nëse konstatohet shkelja, atëherë kjo do të përbente një shkelje penale me pasoja mbi gjithë procesin zgjedhor të zhvilluar në ambientet e Shkollës "Arben Broci", duke e shpallur këtë proces si të pavlefshëm.

**6 Sipas burimeve zyrtare, mbi 17.000 qytetarëve të Qarkut Tiranë iu mohua e drejta për të votuar për shkak se ishin të infektuar me COVID-19, dhe organet e shtetit dhe KQZ-ja nuk ndërmorrën masa për t'ia mundësuar votimin në spitale apo në vendet ku ishin të karantinuar.**

Sipas të dhënave zyrtare, raporteve mediatike dhe raportit të OSBE-ODHIR dhe raporti i organizatës ndërkombëtare ENEMO, mbi 17 mijë persona të infektuar me COVID-19 ishin vetëm në Qarkun Tiranë gjatë ditës së zgjedhjeve, që përbën një numër të mjaftueshëm qytetarësh për të nxjerrë një mandat deputeti. KQZ-ja dhe organet shtetërore nuk morën asnjë masë për të mundësuar votimin e atyre që ishin në spitale apo në karantinë, duke ua mohuar këtyre qytetarëve të drejtën e votës, dhe duke ndikuar pashmangshëm te rezultati i zgjedhjeve në Qarkun Tiranë. Në këtë mënyrë është shkelur Neni 43 i Kodit Zgjedhor, si dhe e drejta e përcaktuar në Nenin 45 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

**7 Qeveria vendosi arbitrarisht dhe pa paralajmërim masën për karantinë dy javore për qytetarët që ktheheshin nga Greqia dhe Maqedonia e Veriut, duke ndikuar negativisht drejtpërdrejt tek e drejta e votës e këtyre qytetarëve.**

Në datën 19 prill 2021 Komiteti Teknik i Ekspertëve i Qeverisë së Republikës së Shqipërisë vendosi masën për një karantinë 2 javore për qytetarët që ktheheshin të votonin nga Greqia dhe Maqedonia e Veriut (<https://shendetesia.gov.al/komiteti-teknik-i-eksperteve-rikthehen-ne-klasa-shkollat-e-mesme-karantine-2-javore-per-personat-qe-vijne-nga-maqedonia-e-veriut-dhe-greqia/>), duke ndikuar negativisht tek e drejta e votës së qindra mijëra qytetarëve të Shqipërisë që jetojnë në këto dy shtete në dy mënyra: (a) duke demotivuar përmes masës së karantinimit ardhjen e tyre në Shqipëri, si dhe (b) duke mos siguruar një mënyrë për votimin e atyre që vendoseshin në karantinë. Ky vendim ka patur pashmangshëm një ndikim të drejtpërdrejt në mandatet për Qarkun e Tiranës. Në këtë mënyrë është shkelur Neni 43 i Kodit Zgjedhor, si dhe e drejta e përcaktuar në Nenin 45 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si në rastin e 17.000 të infektuarëve me COVID-19 në Qarkun Tiranë dhe mungesa e qendrave të posaçme të votimit në spitale dhe vendet e karantinimit të qytetarëve. Të njëjtën problematikë e ka evidentuar edhe organizata KRIIK që ka monitoruar këto zgjedhje, e cila ka konstatuar në raportin e gjetjeve paraprake se "Vetëizolimi i detyruar i qytetarëve që mund të vinin nga Greqia apo Maqedonia, ishte një tjetër kufizim dhe cënim i së drejtës të votës dhe nuk mund të justifikohet asesi me argumentin e dhënë nga Komiteti Teknik për marrjen e tij." (<https://kriik.al/home/wp-content/uploads/2021/04/KRIIK-DeklarataEGjetjeveDheKonkluzioneveParaprake-ZgjedhjetParlamentare2021-210426-1.pdf>).

 Boiken Abazi

**8 Konfigurimi i fletës elektronike të votimit që u përdor në ditën e zgjedhjeve në 32 Qendra Votimi në Tiranë, nuk ishte i njëjtë me atë që u demonstrua publikisht në periudhën e testimit para ditës së zgjedhjeve.**

Në deklaratën për "Gjetjet dhe përfundimet paraprake" të OSBE-ODIHR për zgjedhjet parlamentare të 25 prillit në Shqipëri shkruhet se "U pilotua votimi dhe numërimi elektronik i votave në një prej ZAZ-ve të qytetit të Tiranës, që përfshinte 32 qendra votimi (QV) me 23,597 votues të regjistruar... Procesi i prokurimit të pajisjeve të votimit u mbyll një muaj para ditës së zgjedhjeve, kurse konfigurimi i programit kompjuterik (software) një javë para ditës së zgjedhjeve. Pavarësisht objektit të kufizuar të pilotimit, koha jashtëzakonisht e shkurtër nuk lejoi mundësi për diskutime publike thelbësore apo për një mbikqyrje të pavarur, duke përfshirë edhe nga shoqëria civile, të cilat janë që të dyja komponentë të rëndësishëm për garantimin e besimit në një teknologji të re votimi. Nga 3 deri më 11 prill, në demonstrimet publike morën pjesë 547 zgjedhës. Megjithatë, konfigurimi i fletës elektronike të votimit që u përdor në ditën e zgjedhjeve nuk ishte i njëjtë me atë që u demonstrua publikisht." Sipas po të njëjtit raport "shumë zgjedhës kërkonin asistencë në procesin e votimit.", duke ndikuar te fshehtësia e votës. por potencialisht edhe te përzgjedhja e subjektit nga ana e zgjedhësit. Kjo situatë pashmangshëm ka ndikuar te zgjedhësit ditën e zgjedhjeve, duke shkaktuar paqartësi të shtuara të cilat ndikojnë negativisht tek mënyra se si është shprehur vullneti i qytetarëve gjatë procesit të votimit elektronik, duke vendosur kështu në pikëpyetje vetë rezultatet zgjedhore të atyre Qendrave të Votimit ku u pilotua votimi elektronik.

**9 Presioni ndaj qytetarëve përmes publikimit të një databaze që përmbante të dhënat personale të më shumë se 900.000 qytetarëve shqiptarë. Të dhënat personale, të cilat dyshohet se janë të vjedhura, shoqëroheshin nga vlerësime për preferencat politike dhe elektorale të qytetarëve, duke kërcënuar publikisht fshehtësinë e votës e cila garantohet nga kushtetuta për të gjithë qytetarët. Publikimi i kësaj databaze ka cenuar parimet e përgjithshme të zgjedhjeve dhe përbën një vepër penale që ndikon në procesin zgjedhor.**

Siç kanë raportuar mediat dhe ashtu siç shkruhet edhe në raportin e OSBE-ODHIR për këto zgjedhje, gjatë fushatës, përmes një rrjedhjeje informacioni u zbulua publikisht një databazë me informacione personale dhe detaje kontakti për afërsisht 900,000 qytetarë shqiptarë, që përmbante edhe preferencat e tyre të votimit. Sipas raportit të OSBE-ODHIR, SPAK ka konfirmuar se ka nisur hetimet për këtë rast, megjithatë një vjedhje e këtyre përmasave të të dhënave personale për interes të një partie politike, është në shkelje të të drejtave të parashikuara në Nenin 45, prg. 4 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të Nenit 3, prg. 2, si dhe të Nenit 7 dhe 8 të Kodit Zgjedhor në lidhje me "parimet e përgjithshme". Ekzistenca dhe përdorimi i kësaj databaze krijon një atmosferë presioni dhe frike te qytetarët lidhur me lirinë dhe fshehtësinë e votës, sidomos kur kjo databazë të dhënash përdoret nga parti në pushtet për interesa elektorale, duke ndikuar kështu drejtpërdrejt negativisht te procesi zgjedhor dhe rezultatet e zgjedhjeve në Qarkun Tiranë.

**10 Qytetarëve të Shqipërisë që u gjenden jashtë shtetit iu mohua e drejta e votës, edhe pse kjo është një e drejtë kushtetuese dhe ligjore e përcaktuar edhe në ndryshimet e fundit të Kodit Zgjedhor.**

Boiken Abazi

Ndryshimi i Kodit Zgjedhor në Kuvendin e Republikës, në datën 23 korrik 2020 parashikoi mundësimin e votimit nga jashtë vendit, duke e sanksionuar edhe me ligj këtë të drejtë të qytetarëve të Republikës së Shqipërisë. Ndryshimi i mëtejshëm i Kodit Zgjedhor më 5 tetor 2020 nuk e cenoi të drejtën e qytetarëve për të votuar jashtë vendit. Megjithatë, kjo e drejtë ligjore nuk u mundësua në këto zgjedhje duke ia mohuar të drejtën e votës mbi 1 milion shtetasve të Republikës së Shqipërisë që jetojnë jashtë vendit, me ndikime madhore në rezultatin e Qarkut të Tiranës. Në këtë mënyrë është vepruar në shpërputhje me Nenin 24 dhe 25 të Kodit Zgjedhor. Duhet patur parasysh se në një situatë pandemie, udhëtimi i zgjedhësve nga shtetet e largëta ku jetojnë drejt Shqipërisë, është pamundësuar gjithashtu nga pandemia COVID-19.

#### **11 Keqpërdorimi i punësimeve në administratën publike dhe i fondeve publike me synim dhe rezultat ndikimin në rezultatet e zgjedhjeve.**

Sipas raportit të OSBE-ODHIR (<https://www.osce.org/files/f/documents/0/6/484802.pdf>) mbi gjetjet dhe përfundimet paraprake të zgjedhjeve të 25 prillit 2021: “Moratoriumi ligjor ndaj autorizimit të punësimeve të reja filloi më 25 dhjetor 2020. Sipas Institutit Shqiptar Kombëtar të Statistikave (INSTAT), midis tremujorit të tretë dhe të katërt të vitit 2020, punësimi në sektorin publik është rritur me 6 për qind (nga 171,975 deri në 182,547). Rritja në të njëjtin tremujor në vitin 2018 dhe 2019 ishte përkatësisht 1 dhe 0 për qind. Më 24 dhjetor, qeveria autorizoi edhe 2,472 pozicione të tjera.” Neni 91 i Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë parashikon ndalimin e veprimtarive të tilla nga institucionet publike katër muaj para zgjedhjeve. Ky nen është vendosur në Kod më synimin për të ndaluar punësimet klienteliste për përfitime politike nga ana e partive në pushtet. Rritja e jashtëzakonshme e punësimeve mes tremujorit të tretë dhe të katërt të vitit 2020 si dhe një ditë para afatit 4 muaj para datës së zgjedhjeve, dëshmon se partia në pushtet e ka shfrytëzuar administratën publike duke shkelur frymën e këtij ligji, i cili tenton të parandalojë pikërisht atë që ka ndodhur me punësimet e konsiderueshme në administratë. Në këtë rast kemi të bëjmë me një krypto-blerje të votës së qytetarëve të punësuar në shkelje të frymës së ligjit, që pashmangshëm ka ndikuar në rezultatet e Qarkut Tiranë, administrata publike e të cilit është rritur konsiderueshëm për shkak të këtyre punësimeve në minutë të fundit.

Sipas të dhënave të Ministrisë së Financave dhe bazuar mbi raportimin e datës 15.04.2021 të gazetës “Monitor: “Të dhënat zyrtare të Ministrisë së Financave tregojnë se gjatë periudhës janar-mars 2021 u shpenzuan për investime 11,3 miliardë lekë. Kjo shumë ishte 118% më e lartë se fondi i shpenzuar në tremujorin e parë të vitit të kaluar. Ky është niveli më i lartë i shpenzimeve kapitale në tre muajt e parë të vitit, që nga viti 2013, edhe atëherë përpara zgjedhjeve të përgjithshme të atij viti.”. Sipas po të njëjtit raport, më shumë se gjysma e projekteve të financuara gjatë tremujorit të parë të vitit 2021 nuk ishin projekte të programuara për financim këtë vit. Në këtë rast kemi të bëjmë me shkelje në gjurmë dhe në frymë të ligjit të Kodit Zgjedhor, përkatësisht Nenit 91, me pasojë në rezultatin e zgjedhjeve përmes krypto-blerjes së votës.

Në lidhje me fondin e rindërtimit, në katër muajt e parë të vitit 2021, Qeveria ka shpenzuar në formë Transfertash të Pakushtëzuar 56% të totalit të fondit, një pjesë e mirë e të cilit ka qenë për

Boilena Hoxhi

transferta individuale. Bazuar mbi të dhënat e Ministrisë së Financave dhe "Open Data Albania" (Marrë nga <http://ndiqparate.al/2021/05/07/periudha-zgjedhore-dhe-fondi-i-rindertimit-shtesa-buxhetore-ne-transferte-e-pakushtezuar-per-11-bashki/>). Më tej, në po të njëjtin raport konstatohet se "Në Ligjin për Buxhetin e Shtetit të Fillim Vitit, në total Transfertat e Pakushtëzuara për këto 11 Bashki ishin 8 299 271 265 Lekë. Po për këto 11 bashki shtesa e Transfertave të Pakushtëzuara përmes VKM në katër muajt parazgjedhor shënon shtesë 15 430 836 420 Lekë. Rritja është me 186 përqind. Në vlerë rritjen më të lartë e kanë bashkitë Tiranë; Durrës; Kurbin dhe Kamëz. Si peshë kundrejt Transfertave të Pakushtëzuara të Parashikuara në Ligjin e Fillim Vitit, rekord mbajnë bashki si Vora (549%); Kurbin (340%); Tirana (250%); Shijaku (228%)." Për më shumë "Bashkia Tiranë. Me Vendime të Këshillit të Ministrave ka përfituar shtesa Transferta të Pakushtëzuara në Data Zgjedhore (30 ditët e fushatës) në vlerën 6 055 001 800 Lekë (gjashtë miliard e pesëdhjetë e pesë milion e njëmijë e tetëdhjetë Lekë). Këto transferta janë urdhëruar me VKM Nr. 189, datë 25 Mars; VKM Nr. 202 datë 25 Mars; VKM Nr. 204 datë 25 Mars.". Të gjitha këto transferta të pakushtëzuara të planifikuara në fillim të vitit, si dhe shtesat e vendosura për bashkitë e Qarkut Tiranë, janë veprime të cilat nuk janë kryer më herët gjatë vitit 2020, por vetëm tani në prag të zgjedhjeve, duke mundësuar keqpërdorimin e këtyre transfertave tek bashkitë e qarkut Tiranë si dhe tek transfertat direkte tek personat fizikë me synim ndikimin tek vota e qytetarëve në shkelje të frymës së Kodit Zgjedhor si dhe nenit 91 të këtij kodi.

\*\*\*

Në përfundim të kësaj Ankese drejtuar KQZ/KAS vlen të përmendet se problemet dhe shkeljet e lidhura me gjithë procesin zgjedhor të zgjedhjeve parlamentare të 25 prillit në Republikën e Shqipërisë kanë nisur para fushatës, gjatë fushatës, ditën e zgjedhjeve dhe kanë vazhduar edhe gjatë procesit të numërimit.

Influencimi i votuesve përmes shpenzimit të shumave të mëdha të parave nga buxheti i shtetit, përmes punësimeve, përmes shërbimeve burokratike (siç janë legalizimet), është vetëm njëri aspekt i blerjes së votës. Aspekt tjetër i blerjes së votës është edhe angazhimi i parave nga ekonomia informale, apo kriminale, me angazhimin në fushatë të personave për të cilët institucionet janë shprehur duke ua pamundësuar kandidimin për shkak të aktiviteteve të tyre të paligjshme. Këtyre personave iu pamundësua kandidimi, por jo angazhimi në fushatë, dhe as përdorimi i kapitalit të tyre për të blerë vota. Pra, kemi blerjen e bërë me para publike, për të cilën fajin e ka ekskluzivisht qeveria dhe pushteti lokal, të kontrolluara nga një parti e vetme, por edhe blerjen e bërë me para nga ekonomia informale e ajo kriminale, e për këtë fajtorë janë disa parti.

Përveç blerjes, impakt në manipulimin e vullnetit të votuesve, ka patur edhe kërcënimi, shantazhi e frika. Pamjet filmike të kryeministrit, i cili gjatë fushatës u thoshte pronarëve të bizneseve që t'i largojnë punëtorët e tyre shqiptarë dhe t'i zëvendësojnë ata me punëtorë nga shtete të tjera, nuk janë gjë tjetër përveçse një kërcënim i drejtpërdrejtë për punëtorët shqiptarë të cilët pas pak ditësh do të shkonin të votonin. Publikimi i databazës me të dhëna personale, e njohur si "lista e patronazhistëve", e ka vënë secilin qytetar përballë presionit. Secili tashmë e ka adresën, emrin e vet dhe të familjarëve, por edhe kontaktet e të dhëna të tjera, të publikuara dhe të aksesueshme nga cilido person që mund të ketë dëshirë të hakmerret mbi ta. Ky ka qenë kërcënim nga partia

Boiken Abazi

në pushtet, por ka patur edhe kërcënim nga individë. Në media janë publikuar raste të personave të liruar nga burgjet gjatë periudhës së fushatës, ndërkohë që personat e dyshuar për aktivitete kriminale, të cilëve u është ndaluar kandidimi, morën pjesë si protagonistë në fushatë, me gjithë kërcënimin që kjo përbën për qytetarët e zakonshëm të dhënat private të të cilëve tashmë ishin të ekspozuara.

Për shkak të degradimit thuajse total të procesit të numërimit, siç dëshmohet në Argumentet e kësaj ankese, Kandidati i Pavaruar Boiken Abazi, në mëngjesin e datës 27.04.2021 tërhoqi nga VNV-të të gjithë vëzhguesit e akredituar në emër të tij (<https://lapsi.al/2021/04/27/vetevendosja-terheq-vezhguesit-deformim-masiv-votash-ne-funksion-te-pushtetit/>) dhe nisi procesin e përgatitjes së ankesave për gjithë Qarkun Tiranë. Mirëpo duhet theksuar se problemet kanë nisur ende pa nisur fushata, ashtu siç shpjegohet edhe në këtë ankesë, me raste që prekin keqpërdorimin e administratës publike dhe fondeve publike. Në SPAK janë dorëzuar disa akuza për shit-blerje vote, por siç deklaroi edhe Drejtuesja e misionit të OSBE/ODIHR, Ambasadorja Urszula Gacek në intervistën për DW: “Ne kemi pasur një shqetësim më të madh sesa shit-blerja e votës: keqpërdorimin e burimeve të administratës shtetërore, qëndrimin e turbullt ndaj kufirit mes partisë dhe shtetit”. (Marrë nga: <https://www.dw.com/sq/zgjedhjet-n%C3%AB-shqip%C3%ABri-gacek-v%C3%ABmendje-e-madhe-ndaj-%C3%A7do-ankimi-apo-rinum%C3%ABrimi-votash/a-57384936>). Përveç rasteve të dhunës brenda dhe jashtë VNV-e të përmendura në këtë Ankesë, duhen theksuar edhe dy konfliktet e armatosura, të lidhura me subjektet politike, që kanë ndodhur në Kavajë dhe në Elbasan, të cilat kanë lënë një person të vrarë dhe disa të plagosur. Kur kësaj situatë i shton edhe vjedhjen e të dhënave personale të qytetarëve, është e qartë se nuk kemi të bëjmë më një proces normal dhe demokratik zgjedhor. Nuk kemi të bëjmë me zgjedhje të lira dhe të ndershme. E gjithë kjo është rënduar edhe më shumë nga pandemia dhe mohimi i të drejtës së votës për mijëra qytetarë të infektuar në Qarkun Tiranë, si dhe shumë qytetarë të tjerë do të kishin ardhur të votonin në këto zgjedhje nëse nuk do të kishte qenë pandemia dhe masat e mara nga instucionet. Situata e tensionuar dhe shkeljet e shumta kanë ndikuar pashmangshëm te rezultati i këtyre zgjedhjeve, duke e legjitimuar kërkesën për shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në atë shumë Qendra Votimi të Qarkut Tiranë, sa do të ishte e domosdoshme shpallja e pavlefshmërisë dhe përsëritja e zgjedhjeve në të gjithë Qarkun Tiranë.

Në bazë të Nenit 124 dhe 160 të Kodit Zgjedhor, si dhe bazuar mbi argumentet e kësaj Ankese, kërkojmë shpalljen e pavlefshmërisë për Tabelat Përmbledhëse të Rezultatit për Zonën Zgjedhore Qarku Tiranë.

Boiken Abazi